



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2387/ 2 prot

Datë 29.09.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-74544-07-07-2023, me objekt: “Loti 4: “Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët - materiale mobilim urban lëndë e parë Faza II”, me fond limit 104,166,667.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit
- Ankimues:** “Albgarden” SHPK me NIPT K37513520N dhe adresë: Lagjja “Skenderbeg”, godinë private 1 katëshe në superstradën lezhë-Shkodër, km1, Lezhë
- Autoriteti Kontraktor:** Fondi Shqiptar i Zhvillimit me adresë: Rruga “Sami Frashëri”, Tiranë
- Subjekte të Interesuara:** “Leon Konstruksion” SHPK me NIPT: K71820009I dhe adresë: Tirane Rruga Tish Dahia, Kompleksi Kika 2, Pallati nr.9, Kati 8

Në datën 28.09.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3454 dhe me nr. 2387/2023 prot., datë 29.09.2023 e operatorit ekonomik “Albgarden” SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik “Albgarden SHPK me anë të ankesës me numër ankimi elektronik A/2023/3454 dhe me nr. 2387/2023 prot., datë 29.09.2023, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK, të kriterëve si më poshtë:

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

2.9 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.3 Operatori duhet të disponojë të paktën 4 mjete që nevojiten me qëllim transportin e mallrave, të cilët duhet t'i ketë në pronësi ose me qira.

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Kamion me vinç	4	Pronësi ose me qira

- Për mjetet që janë në pronësi duhet të paraqiten dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit, leja e qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit i vlefshëm.
- Për mjetet që janë me qira krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

- Gjithashtu operatori ekonomik ankimues “Albgarden SHPK pretendon se operatori ekonomik “Leon Konstruksion” nuk plotëson kriterin e kualifikimit për plotësimin e shtojcës 8 FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT sipas përcaktimeve të AK. Nga verifikimi i shtojcës 8 FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT të përpiluar dhe dorëzuar nga OE “Leon Konstruksion” shpk rezulton se të dhënat e paraqitura në këtë formular nuk janë të sakta. Më konkretisht të dhënat e paraqitura nga OE “Leon Konstruksion” shpk për mjetet e kërkuara si dhe për kontratat e ngjashme rezultojnë të jenë të pa sakta. Në këto kushte ky OE duhet të skualifikohet.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 29.09.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri